

## **Hapet thirrja për bursa për personelin akademik dhe ndihmës akademik /administrativ me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës në kuadër të Programit Erasmus + në Universitetin Almeria, Spanjë, për semestrin e dytë të vitit akademik 2021-2022**

Në kuadër të programit Erasmus+ është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për personelin akademik dhe ndihmës akademik / administrativ me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës në Universitetin Almeria, Spanjë.

[https://www.ual.es/en?idioma=en\\_GB](https://www.ual.es/en?idioma=en_GB)

### **Llojet e mobilitetit përfshijnë:**

- Shkëmbimin e personelin akademik për mësimdhënie/trajnim;
- Shkëmbimin e personelin ndihmës akademik me karakter administrativ për trajnim.

### **Kohëzgjatja e mobilitetit:**

- 5 ditë + 2 ditët e udhëtimit (trajnimi 25-29 Prill 2022);

### **Fusha e mobilitetit për mësimdhënie :**

- Kontabilitet;
- Financë-Bankë;
- Menaxhim dhe Administrim;
- Marketing;
- Ekonomiks;
- Gjuhë e huaj (Anglisht ose Spanjisht);

### **Bursat përfshijnë:**

- Kompensimin ditor për stafin (160 EUR në ditë);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

<b>DISTANCA E UDHËTIMIT</b> ( <a href="http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm">http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm</a> )	<b>Kompensimi</b>
<b>Midis 100 dhe 499 KM</b>	180 EUR
<b>Midis 500 dhe 1999 KM</b>	275 EUR
<b>Midis 2000 dhe 2999 KM</b>	360 EUR
<b>Midis 3000 dhe 3999 KM</b>	530 EUR
<b>Midis 4000 dhe 7999 KM</b>	820 EUR
<b>8000 KM ose më shumë</b>	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni:

[http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance\\_en.htm](http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)

### **Dokumentat e nevojshme për aplikim :**

- CV (në gjuhën angleze) + Lista e publikimeve (për personelin akademik);
- Kopje e Pasaportës;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze / spanjolle);
- Vërtetim punësimi (në gjuhën shqipe);
- Certifikata e gjuhës së huaj (anglisht ose spanjisht);
- Vetëdeklarim nëse keni kryer ose jo më parë një mobilitet në kuadër të programit Erasmus+ dhe nëse po, ku;
- Plani i mobilitetit për mësimdhënie\*;

\*Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për Mësimdhënie klikoni në adresën:

[https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Mobility\\_Agreement\\_Teaching\\_outgoing-1-1.docx](https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Mobility_Agreement_Teaching_outgoing-1-1.docx)

- Plani i mobilitetit për trajnim;

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për Trajnim klikoni në adresën:

[https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Mobility\\_Agreement\\_Training\\_outgoing-1.docx](https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Mobility_Agreement_Training_outgoing-1.docx)

Plani i Mobilitetit për mësimdhënie / trajnim është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së mësimdhënies / trajnimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti në momentin e aplikimit dhe më pas nga Koordinatorin Institucional Erasmus+.

Afati për aplikim: **11 Shkurt 2022**

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë, si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al).

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al).

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!

